

Kryesia e BIK-së, përmes një kumtese për medie, njofton opinionin dhe besimtarët se Dr. Shefqet Krasniqit nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës në BIK, pra ai, vazhdon të jetë profesor i rregullt në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, aty ku edhe ka qenë më parë.

Ndërsa, për sqarim, e ritheksojmë se Këshilli i Bashkësisë Islame i Prishtinës të njëjtit ia ka ndërprerë kontratën e punës me honorar si ligjërues në Xhaminë e Madhe në Prishtinë.

Lexojeni të plotë deklaratën e BIK:

*Me qëllim të informimit të drejtë, Kryesia e BIK-së njofton opinionin e gjerë dhe besimtarët e saj se Dr. Shefqet Krasniqit nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës në BIK. Pra, ai vazhdon të jetë profesor i rregullt në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, aty ku edhe ka qenë më parë. Ndërsa, për sqarim, e ritheksojmë se Këshilli i Bashkësisë Islame i Prishtinës të njëjtit ia ka ndërprerë kontratën e punës me honorar si ligjërues në Xhaminë e Madhe në Prishtinë. Vendimi i Këshilli të BI-së së Prishtinës është në përputhje të plotë me të gjitha aktet normative në fuqi.*

*Prandaj, ftojme besimtarët tanë që mos të bien pre e spekulimeve dhe manipulimeve që janë duke qarkulluar këto ditë nëpër qarqe të ndryshme përmes rrjeteve sociale se gjoja BIK ka përjashtuar nga puna Shefqet Krasniqin.*